

BULETINI 2025



KOMUNA E LIPJANIT



GUSHT

Nata përmbyllëse e “Mërgata Fest & Sports 2025” një mbrëmje me atmosferë fantastike



Nata përmbyllëse e festivalit “Mërgata Fest & Sports 2025” solli një atmosferë të jashtëzakonshme , duke kurorëzuar tri net festimesh me muzikë, gjallëri dhe pjesëmarrje të madhe të qytetarëve dhe mërgimtarëve tanë.

Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, shprehu mirënjohje për të gjithë qytetarët dhe mërgimtarët që ishin pjesë e këtij festivali:

“Faleminderit qytetarëve të Lipjanit dhe mërgimtarëve tanë për pjesëmarrjen e madhe dhe atmosferën fantastike. Ju e bëtë këtë festival një ngjarje të jashtëzakonshme”, ka thënë Kryetari z. Imri Ahmeti.

Performancat e artistëve të njohur dhe energjia e publikut e shndërruan këtë mbrëmje në një festë të paharruar, në sheshin “Adem Jashari” në Lipjan.

Ky festival u mbështet nga Komuna e Lipjanit – DKRS dhe u implementua nga OJQ ESRA Environmental and Social Responsibility Association.

Vendoset gurthemeli i Muzeut të Veteranëve të UÇK-së në Krojmir



Në fshatin Krojmir, është vendosur gurthemeli i Muzeut të Veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, një projekt me rëndësi të veçantë për ruajtjen e kujtesës historike dhe nderimin e sakrificës për liri.

Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, theksoi se ky muze do të jetë një hapësirë e përkushtuar për të vërtetën historike të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe do të shërbejë për edukimin e brezave të rinj.

“Sot me plot krenari e mirënjohje, po vendosim gurthemelin e Muzeut të Veteranëve të UÇK-së në Krojmir. Ky objekt i dedikohet vlerave dhe sakrificës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe do të shërbejë si muze për veteranët dhe invalidët e luftës, një hapësirë për ruajtjen dhe përkujdesjen ndaj kujtesës sonë historike”, tha kryetari z. Imri Ahmeti.

Ai shtoi se kemi një detyrim moral dhe institucional që lufta për çlirimin e vendit dhe përpjekjet e bijve e bijave më të mira të këtij vendi të memorohen dhe të dokumentohen, jo vetëm me fjalë, por edhe me vepra konkrete.

Në përfundim të fjalës së tij, kryetari Ahmeti shprehu respekt për veteranët dhe invalidët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Lavdi dëshmorëve të kombit!

Ky projekt është një shprehje e përkushtimit institucional për të nderuar të kaluarën dhe për të ruajtur kujtesën historike.

Filluan dëgjimet publike për planifikimin e buxhetit për vitet 2026–2028



Ka filluar procesi i dëgjimeve publike për planifikimin e buxhetit për periudhën 2026–2028, me synim përfshirjen sa më të gjerë të qytetarëve në përcaktimin e prioriteteve zhvillimore të komunës. Gjatë hapjes së takimit, Drejtori për Buxhet dhe Financa, z. Latif Ramadani, theksoi rëndësinë e këtij procesi për përcaktimin e drejtë të projekteve dhe investimeve që do të përfshihen në buxhet. Ai theksoi se dëgjimet publike janë një mundësi e drejtpërdrejtë për qytetarët që të kontribuojnë me ide dhe propozime konkrete, duke ndikuar në mënyrë aktive në planifikimin e buxhetit komunal.

Takimi i parë u zhvillua me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Kuvendit Komunal, Komitetit për Politikë dhe Financa, Komitetit për Komunitete dhe komiteteve të tjera, përfaqësuesve të grave dhe shoqatave të grave, organizatave të shoqërisë civile, personave me aftësi të kufizuara, të rinjve dhe shoqatave të tyre, klubeve sportive, fermerëve, kryetarëve të fshatrave, si dhe qytetarëve nga Lipjani.

Procesi i dëgjimeve publike do të vazhdojë edhe në vendbanime të tjera të komunës, duke mundësuar përfshirjen e sa më shumë qytetarëve.

Mbahet mbledhja e dytë e KKSBB-së për vitin 2025



Në sallën e takimeve të Komunës së Lipjanit, është mbajtur mbledhja e dytë për vitin 2025 e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi-KKSBB, ku u diskutua për gjendjen e sigurisë në komunën tonë.

Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, në fjalën e tij falënderoi njësinë e zjarrfikësve për reagimin e shpejtë dhe profesional në zonat ku janë shfaqur zjarre, veçanërisht në rastet e djegies së hamulloreve. Po ashtu, ai falënderoi edhe Policinë e Kosovës për angazhimin në garantimin e sigurisë dhe intervenimet në situatat ku është kërkuar prania e saj.

Gjithashtu, kryetari Ahmeti informoi anëtarët e KKSBB-së për disa projekte të rëndësishme që janë duke u realizuar aktualisht në komunë, të cilat kanë rëndësi të veçantë për qytetarët.

Nënkryetari i Komunës dhe njëherësh kryesues i KKSBB-së, z. Diamant Bytyqi, njoftoi anëtarët e këshillit për procesin e organizimit të dëgjimeve publike lidhur me buxhetin e Komunës së Lipjanit, me theks të veçantë në planifikimin e buxhetit për investimet kapitale për vitet 2026–2028.

Ndërsa, togeri i Stacionit Policor në Lipjan, z. Metush Jashari, prezantoi një pasqyrë të gjendjes së sigurisë në komunë, duke theksuar se situata e përgjithshme është e qetë dhe stabile, me përjashtim të dy rasteve të fundit dhe disa zjarreve të raportuara.

Në këtë mbledhje, udhëheqësi i Njesisë së Zjarrfikësve në Lipjan, z. Sadri Shamolli, prezantoi një raport të detajuar mbi ndërhyrjet e realizuara gjatë kësaj periudhe, përfshirë gjendjen e zjarreve në territorin e komunës dhe dëmet e shkaktuara prej tyre.

Vazhdojnë dëgjimet publike për Planifikimin e Buxhetit për vitet 2026–2028



Komuna e Lipjanit ka vazhduar me mbajtjen e dëgjimeve publike në kuadër të Planifikimit të Buxhetit për periudhën 2026–2028, me synim përfshirjen aktive të qytetarëve në procesin vendimmarrës dhe në përcaktimin e prioriteteve zhvillimore të vendbanimeve të tyre.

Drejtori për Buxhet dhe Financa, z. Latif Ramadani, prezantoi në pika të shkurtra përbërjen e buxhetit dhe theksoi rëndësinë e bashkëpunimit të ngushtë me qytetarët për hartimin e një buxheti të balancuar dhe gjithëpërfshirës, që adreson realisht nevojat e qytetarëve.

Gjatë këtyre takimeve, të mbajtura në Grackë të Vjetër, Sillovi dhe Ribar i Madh, qytetarët patën mundësinë të paraqesin propozimet dhe kërkesat e tyre për projekte që i konsiderojnë të domosdoshme për lokalitetet e tyre.

Komuna e Lipjanit mbetet e përkushtuar të sigurojë transparencë, gjithëpërfshirje dhe llogaridhënie në të gjitha fazat e planifikimit buxhetor.

Përmbillet dita e tretë e dëgjimeve publike për Planifikimin e Buxhetit 2026–2028



Komuna e Lipjanit ka përmbyllur ditën e tretë të dëgjimeve publike për Planifikimin e Buxhetit për periudhën 2026–2028, me qëllim përfshirjen aktive të qytetarëve në përcaktimin e prioriteteve dhe nevojave zhvillimore të lokaliteteve.

Drejtori për Buxhet dhe Financa, z. Latif Ramadani, vlerësoi pjesëmarrjen e qytetarëve dhe theksoi se dialogu i drejtpërdrejtë me ta është çelësi për hartimin e një buxheti që pasqyron realisht prioritetet e qytetarëve. Ai prezantoi gjithashtu pikat kryesore të buxhetit dhe nënvizoi rëndësinë e përfshirjes së të gjithëve në këtë proces.

Gjatë takimeve në Shalë dhe Magurë, qytetarët patën mundësinë të paraqesin propozime, kërkesa dhe ide për projekte që i konsiderojnë të domosdoshme për zhvillimin e lokalitetit të tyre. Komuna e Lipjanit mbetet e përkushtuar për një proces buxhetor gjithëpërfshirës, transparent dhe të orientuar drejt zhvillimit të qëndrueshëm.

Rinia Fest 2025 – Një ditë plot kreativitet dhe argëtim me të rinjtë



Në Sheshin “Adem Jashari” u zhvillua Panairi Rinor, në kuadër të programit “Rinia Fest 2025”. Ky aktivitet i dedikuar për të rinjtë, krijoi një atmosferë festive për të gjithë pjesëmarrësit.

Të rinjtë patën mundësinë të përjetojnë për herë të parë eksperiencën unike me Syzet VR, ku lojërat interaktive i transportuan në një botë virtuale magjike.

Punëtoritë e argjilës ofruan mundësi kreative për të krijuar objekte unike, të cilat pjesëmarrësit i morën me vete si kujtim nga kjo ditë e veçantë.

Ngjarja u shoqërua me lojëra argëtuese, muzikë dhe dhurata surprizë për të gjithë të rinjtë që morën pjesë.

Dita Ndërkombëtare e Rinisë



Në sheshin "Adem Jashari" në Lipjan, u mbajt koncerti "Rinia Fest 2025", me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Rinisë, i cili u shndërrua në një atmosferë fantastike falë energjisë së të rinjve të shumtë të qytetit tonë.

Këngëtarët e njohur ndezën skenën me performanca plot energji, duke sjellë një atmosferë unike që vetëm rinia mund ta krijojë. Ndërsa në sheshin e qytetit parakaluan valltarët e organizatës austriake, të veshur me kostume tradicionale, duke tërhequr vëmendjen dhe admirimin e shumë qytetarëve.

Në shenjë mirënjohjeje, Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, nderoi përfaqësuesit e organizatës austriake me mirënjohje për bashkëpunimin kulturor, i cili i shton vlerë Lipjanit. Nga ana tjetër, përfaqësuesit e organizatës i dhuruan Kryetarit Ahmeti një suvenir simbolik, si shenjë falënderimi për mikpritjen. Faleminderit të gjithë artistëve, të rinjve dhe qytetarëve që ishin pjesë e kësaj feste të veçantë, duke e bërë Ditën Ndërkombëtare të Rinisë një kujtim të paharrueshëm.

Panairi i Prodhimeve Vendore



Komuna e Lipjanit organizoi në sheshin "Adem Jashari" Panairin e Prodhimeve Vendore, një ngjarje tre-ditore që promovon punën, përkushtimin dhe kreativitetin e prodhuesve vendor.

Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, gjatë vizitës së tij, theksoi se mbështetja e prodhimeve vendore është jo vetëm një vlerësim për punën e prodhuesve, por edhe një investim i drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik dhe të ardhmen e qëndrueshme të komunës.

Panairi ofron një gamë të gjerë prodhimesh, duke përfshirë veshje tradicionale, produkte bujqësore dhe blegtorale, ushqime, si dhe punime artizanale.

Komuna e Lipjanit përfiton nga projekti “Forcimi i qeverisjes shumënivelëshe dhe demokracisë pjesëmarrëse” nga Këshilli i Evropës



Nënkryetari i Komunës, z. Diamant Bytyqi, ka nënshkruar marrëveshjen e grantit me znj. Mary Ann Hennessey, Shefe e Zyrës së Këshillit të Evropës në Prishtinë, ku Komuna e Lipjanit është përfituese për të zbatuar projektin “Forcimi i qeverisjes shumënivelëshe dhe demokracisë pjesëmarrëse”.

Projekti parashikon vendosjen e Ekranit të Qytetarit për transparencë dhe pjesëmarrje në ambientet e komunës së Lipjanit.

Ky projekt, i financuar tërësisht nga Këshilli i Evropës, është një iniciativë që synon avancimin e qeverisjes së hapur dhe promovimin e demokracisë pjesëmarrëse në nivel lokal. Poashtu mbështet aktivitetet për rritjen e transparencës, pjesëmarrjes qytetare dhe llogaridhënies në komunën tonë.

Projekti do të realizohet gjatë vitit 2025 dhe përmes tij do të mundësohet qasje e lehtë në informacione dhe do të fuqizoj rolin e qytetarëve në vendimmarrje, duke përfshirë edhe të rinjtë, gratë dhe personat me aftësi të kufizuara.

Komuna e Lipjanit është e përkushtuar për të avancuar praktikat e qeverisjes së hapur dhe për të forcuar demokracinë lokale.

Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, ka pritur në takim një delegacion biznesmenësh nga Turqia.



Gjatë takimit u diskutua mbi zhvillimet në Komunën e Lipjanit dhe mundësitë për bashkëpunim të ndërsjellë në fushat me interes të përbashkët.



Komuna e Lipjanit – Zyra për informim



<https://lipjan.rks-gov.net/>



infokomuna.lipjan@rks-gov.net



0 800 14 000 / 038 200 41 508